



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN-MAT

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues KB2 Erzen, Nr.Prot. 7/, Data 4.7.2025,

Shkurtimi
lëndës Daym dolburi i

Për trajtim nga:	<u>D. Sapuni, N. Muço</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Të shkrahën, Dergohen në AMBU</u>
Me porosi	

Afati: ☐ Normal (7 ditë) ☐ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (brenda ditës) ☐ Pa afat/për dijeni
Tjetër ditë

Data 4.6.25 Nr. Prot. 253/4 Nënshkrimi:(Titullari) [Signature]

Marrë në dorëzim: _____, Nënshkrimi: _____
Kalon për trajtim (stuktura): _____
Meporositë: _____

Marrë në dorëzim: _____, Nënshkrimi: _____
Kalon për trajtim (stuktura): _____
Me porositë: _____


Marrë në dorëzim: _____, Nënshkrimi: _____
Kalon për trajtim Specialisti : _____
Me porositë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____, Specialisti
Trajtimi i materialit pranuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit pranuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike

Adresa: _____ Web: <http://www.ambu.gov.al>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN



Nr. 7/7 prot.

Tiranë më 4.7.2025

Lënda: Dërgim i dokumentacionit të nënshkruar.

Z. HELIO HUQI
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BASENIT LUMOR ISHËM-ERZEN-MAT

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", godina "Shtëpia Botuese Toena", kati IV, Tiranë

Referuar shkresës suaj me nr.253/3 prot., datë 04.07.2025, mbi formalizimin e materialeve të mbledhjes së Këshillit të Basenit Lumor Erzen, të zhvilluar më datë 10.06.2025, bashkëlidhur ju dërgojmë kopjet e nënshkruara të akteve të miratuara, si më poshtë:

1. Vendim nr.2, datë 10.06.2025: "Për Miratimin e Autorizimit për Përdorim Burimi Ujor Sipërfaqësor për Turizëm, Argëtim, Lundrim për Argëtim, z.. -3 (tre) kopje;
- Autorizim për Përdorim Burimi Ujor Sipërfaqësor me nr. serial 000004; - 3 (tre) kopje;
2. Raporti përmbledhës: "Raport mbi mbledhjen dhe vendimet e datës 10.06.2025 të Këshillit të Basenit Lumor Erzen" - 2 (dy) kopje;
3. Procesverbali i mbledhjes - 1 (një) kopje në origjinal.

KRYETARI
AFRIM QËNDRO





7/4
4.7.25
KBL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

VENDIM

Nr.2, datë 10/06/2025

PËR

MIRATIMIN E AUTORIZIMIT PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR TURIZËM, ARGËTIM, LUNDRIM PËR
ARGËTIM, Z.DOD DOÇI P.F

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim, z.Dod Doçi, me vendndodhje: Deti Adriatik, Gjiri i Lalzit, Bashkia Durrës.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Deti Adriatik

Vendndodhja e burimit (KRGJSH):

1.X= 459290.4;	Y= 4596788.4;	Z=0 m.m.n.d;
2.X= 459288.5;	Y= 4596727.9;	Z=0 m.m.n.d;
3.X= 459324.0;	Y= 4596727.4;	Z=0 m.m.n.d;

4.X= 459325.4;	Y= 4596787.3;	Z=0 m.m.n.d;
5.X= 459339.7;	Y= 4596758.2;	Z=0 m.m.n.d;
6.X= 459339.8;	Y= 4596754.3;	Z=0 m.m.n.d;
7.X= 459324.9;	Y= 4596754.6;	Z=0 m.m.n.d;
8.X= 459324.9;	Y= 4596758.6;	Z=0 m.m.n.d;

- Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji. Lojra për argëtim.
 - Periudha e përdorimit të ujit: Nga 1 Maj – 15 Nëntor.
3. Ky vendim është i vlefshëm vetëm nëse subjekti është i pajisur me Kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit për parcelën DR-49, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ERZEN

AFRIM QËNDRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

Nr 7/6 prot

Datë, 4/7 /2025

RAPORT

MBI MBLEDHJEN DHE VENDIMET E DATËS 10.06.2025 TË

KËSHILLIT TË BASENIT LUMOR ERZEN

Këshilli i Basenit Lumor ERZEN (KBL) zhvilloi mbledhjen e rradhës në datë **10.06.2025** ora 11⁰⁰ pranë ambienteve të Prefekturës Tiranë . Në mbledhjen e datës **10.06.2025** morën pjesë 13 anëtarë dhe Kryetari i KBL Erzen Z. Afrim Qëndro duke u plotësuar kourumi për vendimmarrje. Gjithashtu morën pjesë:

Z. Helio Huqi, Drejtor të Zyrës së Administrimit të Basenit Lumor Ishëm-Erzen-Mat (ZABU) në cilësinë e sekretarit të KBL-së, Z.Kujtim Muço përfaqësues i AMBU-së,Z.Geldon Strugaj Znj. Dorina Çapuni, specialiste ne ZABU Ishëm-Erzen-Mat me detyrën e mbajtësit të proces-verbalit, si dhe Z.Herian Mele përfaqësues nga Institucioni i Prefektit Tiranë

Anëtarët e KBL Erzen të pranishëm ishin si më poshtë:

1. Albion Kadriu – Drejtor, AdZM
2. Artan Tanuçi – Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Durrës
3. Enton Osmani – Grup Interesi, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë
4. Gimjan Doke- Pergjegjës, Sektori i Higjenës Publike
5. Ermal Arapi –Drejtor, ARM Tiranë
6. Dhimitër Llakmani –Grup Interesi
7. Baki Dervishi– ZV/Kryetar, bashkia Kavajë
8. Anxhela Delaj – Përgjegjës,bashkia Durrës

Z.Afrim Qëndro pasi falenderoi anëtarët për pjesëmarrjen deklaroi mbledhjen e hapur duke qënë se kourumi është i plotësuar dhe vijoi prezantimin e rendit të ditës.

1. Kërkesë për “Për miratimin e autorizimit për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim Z.Dod Doçi person fizik”, me vendodhje; deti Adriatik,Gjiri Lalzit,bashkia Durrës.
2. Të ndryshme.

-Merr fjalën **Z. Helio Huqi**,para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës dua të pyes anëtarët,bazuar në ligjin për konfliktin e interesit, kanë detyrimin ligjor të deklarojnë nëse kanë ndonjë konflikt interesi me rendin e ditës?

Të gjithë anëtarët shprehen se nuk kanë konflikt interesi me rendin e ditës dhe se mbajnë përgjegjësi personale në rast të kundërt, sipas parashikimit të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ushtrimin e funksionit publik"

Z.Helio Huqi vazhdon me pikën e vetme të rendit të ditës, në fjalën e tij bëri një prezantim të shkurtër të kërkesës së subjektit; Nëpërmjet sistemit elektronik e-leje "Aplikim për përdorim burimi ujqor", z.Dod Doçi P.F, ka paraqitur kërkesën për autorizim për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim, *me vendndodhje: Deti Adriatik, Plazhi Rrashbullit, Bashkia Durrës*. Subjekti ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor. Në sistem është ngarkuar edhe Kontrata për Përdorimin e Hapësirës së Plazhit/Kontratë Qiraje e nënshkruar midis subjektit "Dod Doçi" P.F, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë Durrës në datën 16.07.2021 me afat vlefshmërie 5 vjet, për sezonin turistik 2021-2025, Parcela DR-49 që do të përdoret ka sipërfaqe totale 1000m² dhe ndodhet në zonën e quajtur "Gjiri i Lalzit". AMBU pasi ka vlerësuar dokumentacionin e plotësuar e sjellim në Këshill për vendimarrje.

Z.Afrim Qëndro fton anëtarët dhe pjesëmarrësit në mbledhje për diskutim në lidhje me këtë pikë;

Z.Herian Mele diskutoi në lidhje me përmasat e parcelës, në relacion kemi vënë re se parcela ka një sipërfaqe prej 1000 m², ndërsa përmasat e strukturës që do të vendoset janë 29x49 që përlllogariten rreth 1400 m². Për të qënë sa më të saktë a ka ndonjë kriter se sa duhet të jenë përmasat e strukturës në lidhje me parcelën e dhënë.

Z.Helio Huqi sqaroi se në VKM nuk është e përcaktuar, kushti është vetëm se ; duhet të ketë marrëveshje me bashkinë përkatëse ku do të kryhet aktiviteti.

Z.Afrim Qëndro shtoi se AMBU-së mund t'i shkruhet një shkresë ku të kërkohet se a do ketë ndonjë udhëzim se si do të jetë raporti midis sipërfaqes së shfrytëzuar dhe sipërfaqes së platformës që do të jetë në det, apo do jetë në bazë të kërkesës. E rëndësishme është që subjekti ka një kontratë të miratuar në lidhje me aktivitetin që do të kryjë.

Një shqetësim tjetër që ngriti **Z.Afrim Qëndro** ishte siguria teknike e lojrave në det, cilat janë masat e sigurisë që merren, kush e ka përdorur që të marri masat e duhura? Është një vakum ligjor në lidhje me institucionin i cili duhet të mbikqyrë aktivitetin e lojrave në bregdet.

Z.Gimjan Dokle dha shembullin për hapjen e aktivitetit të pishinave të cilat duhet të përmbushin kërkesat higjieno-sanitare.

Z.Afrim Qëndro shtoi se nuk është ky rasti, shqetësimi i tij në këtë rast është se kush është subjekti privat apo publik që garanton sigurinë e personave që do të lujane dhe gjatë aktivitetit mos t'u ndodhi ndonjë dëm fizik. Ne japim të drejtën e shfrytëzimit të basenit ujqor (detit në këtë rast), por nuk ka një ligj i cili të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik. Ne si Këshill nuk

kemi përgjegjësi për sigurinë teknike, por përderisa lëshojmë një leje duhet ta ngremë këtë shqetësim për sigurinë e jetës së qytetarëve.

Për këtë situatë **Z.Afrim Qëndro** ishte i mendimit që të kërkohej me anë të një shkrese ku t'i drejtohet bashkisë përkatëse, për të qartësuar këtë problematikë për masat që duhet të merren në lidhje me sigurinë e qytetarëve.

Pas këtij diskutimi **Z.Afrim Qëndro** pyeti sërish anaëtarët, nëse kanë ndonjë gjë për të shtuar. Kërkesa u hodh në votim dhe u Miratua me të gjitha votat PRO.

Miratohet me 9 vota PRO asnjë kundër.

Z.Helio Huqi diskutoi gjithashtu për ndryshimin e vulës, për shkak të ndryshimit të emërtesës së Këshillit, nga Këshilli i Basenit Ujor Erzen do të bëhet Këshilli i Basenit Lumor Erzen.

Z.Afrim Qëndro caktoi një anëtar nga KBL që të jetë pjesë e komisionit për asgjësimin e vulës, znj. Anxhela Delaj.

Duke falenderuar të gjithë anëtarët Kryetari i KBL Erzen deklaroi mbledhjen e mbyllur

Konkluzione:

Në mbledhjen e KBL Erzen u vendos:

Pika e parë e rendit të ditës miratohet me 9 vota PRO .

- Kërkesë për “Për miratimin e autorizimit për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim Z.Dod Doçi person fizik”, me vendodhje; deti Adriatik, Gjiri Lalzit, bashkia Durrës.
- Pika e dytë e rendit të ditës tek “të ndryshme” u caktua komisioni i asgjësimit të vulës i përbërë nga Z.Helio Huqi Drejtor në ZABL Ishëm-Erzen- Mat, Znj.Blerina Semanjaku, specialist e protokoll arkivës në Institucionin e Prefektit Tiranë dhe Znj.Anxheka Delaj anëtare e KBL Erzen përfaqësuese e Bashkisë Durrës. Procedurat u kryen sipas legjislacionit në fuqi.

Ky raport mbyllet me 3 faqe

DREJTORI I ZABL ISHËM-ERZEN-MAT

Helio Huqi



Mbajtësi i proces-verbalit të mbledhjes së KBL-së

Dorina Çapuni

KRYETARI I KBL ERZEN

Afrim Qëndro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

PROCES - VERBAL

Tiranë, më 10.06.2025

ALBION	KADRIU	Adzim TIRANË
Artan	Tenuca	
Anxhela	Dele	
Enton	Dobani	
Enxan	Dokle	
Enxhel	Arapi	
Dhimitër	LAKEMANI	
Beki	Derishi	
Arman	Arxhani	

Y mbagtur sot në Prefekturën Tiranë ora 11⁰⁰
në dt 10.06.2025.

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i KBC Ergen
& Afrim Qendro pasi folenderoi anëtarët për
pjesëmarrjen konfirmoi kaurumën vijoi me
prezantimin e rendit të ditës

- H-Kerkese për miratimin e autorizimit për përdorim
të burimit ujar superfaqësor për turizëm, argëtim
lundrim & Dod Doçi person fizik me vendndodhje
deti Adriatik, Gjiri i Sëzit, Bashkia e Durrës
- Merr fjalën & Helio Hugi: para se të fillojmë
me pikën e parë të rendit të ditës dua të pyes
anëtarët, bazuar në ligjin për konfliktin e interesit
këni detyrimin ligjor të deklarojnë nëse kanë
ndonjë konflikt interesi me rendin e ditës?
- Të gjithë anëtarët shprehën se nuk kanë konflikt
interesi me rendin e ditës dhe se mbajnë përpjesëtim
personale në rast të kundërt sipas parashikimit
të ligjit nr 9367 dt 02.04.2025 "Për parandalimin
e konfliktit të interesit dhe ushtrimin
e funksionit publik"
- & Helio Hugi vazhdon me pikën e vetme të rendit
të ditës, në fjalën e tij bëri një prezantim të
shkurtër të kerkës së subjektit. Nëpërmjet
sistemit elektronik e-leje & Aplikim për përdorim
burimi ujar & Dod Doçi P.F. ka parqitur kerkesën
për autorizim për përdorim burimi ujar superfaqësor
për turizëm, argëtim, lundrim. Subjekti ka plotësuar

dokumentacionin e nevojshem tekniko-ligjor.
Në sistem është ngarkuar dhe kontrata për
përdorimin e hapësirës së plazhit / kontratë qiraje
enonshkruar midis subjektit « Aool Doçin P.P.
dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë
Durrës në dt 16.07.2021 me afat vlefshmërie 5 vjet
për sezonin turistik 2021-2025. Parcela DR-49
përdoret në sipërfaqe totale 1000m^2 dhe
ndodhet në zonën e quajtur « Gjiri i Fëlgjit »
AMBU pasi ka vlerësuar dokumentacionin e plotësuar
e sjell në Këshill për vendimarrje

- Z. Afrim Qendro fton anëtarët dhe pjesëmarrës
në mbledhje për diskutim
- Z. Herian Mele diskutoi në lidhje me permesat
e parcelës. Në relacion kemi vënë re se parcela
ke një sipërfaqe prej 1000m^2 , ndërsa permesat e
struktureve që do të vendosen janë 29×49 qet
përlogariten rreth 1400m^2 . Për të qenë sa më të
saktë a ka ndonjë kriter se sa duhet të jenë permesat
e struktureve në lidhje me parcelën e dhënë,
- Z. Helio Hugi spjatoi se në VKM-në është e
përcaktuar, kushti është vetëm: duhet të ketë
marreveshje me Bashkinë përkatëse ku do të
kryhet aktiviteti.
- Z. Afrim Qendro shtoi se AMBU-se mund të
dergohet një shkresë ku të kërkohet se a do të
ketë ndonjë udhëzim se si do të jetë reparti
midis sipërfaqes së shfrytëzuar dhe sipërfaqes

se platformes që do të jeto në det, apo do të jeto në baze të kërkesos. E rëndësishme është që subjekti ka një kontratë të miratuar në lidhje me aktivitetin që do të kryej.


Një shqetësim tjetër që ngriti ~~Dr.~~ Afrim Qendro ishte siguria teknike e lojërave në det, cilat janë masat e sigurisë që merren, kush e ka përdetyrë që të marrë masat e duhura? Është një vakum ligjor në lidhje me institucionin i cili duhet të mbikqyrë aktivitetin e lojërave në bregdet.

- ~~Dr.~~ Gjergj Doka dhe shembullin për hapjen e aktivitetit të pishinave të cilat duhet të përmbushin kërkesat higjieno-sanitare
- ~~Dr.~~ Afrim Qendro: shtoi se nuk është ky rast, shqetësimi i ty në këtë rast është se kush është subjekti privat apo publik që garanton sigurinë e personave që do të luajnë dhe gjatë aktivitetit mos t'u ndodhi dëm fizik. Në japim të drejtën e shfrytëzimit të bazenit ujor (detit në këtë rast) por nuk ka një ligj i cili të përcaktonte qartë rregullat e sigurimit teknik. Në si Keshill nuk kemi përgjegjësi për sigurinë teknike, por përdorimi i leshojmë një leje duhet të ngremë këtë shqetësim për sigurinë e jetës së pyetësorëve. Pas këtij diskutimi ~~Dr.~~ Afrim Qendro pyeti serish anëtarët, nëse kanë ndonjë gjë për të shtuar
- Kërkesa u hoq në votim dhe u miratua me të gjitha votat PRO

perfeksione e Bashkise Durrës. Procedurat u kryen sipas legjislativës në fuqi.

Drejtori JABC Ishem - Erzen - Met

Helio Hugi



Kryetari i KBL Erzen

Agrim Qendro

Mbledhja e procesverbalit
to mbledhjes KBL Erzen

Dorina Gajuni



ky proces verbal mbyllet me 6 fope